

**Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group
Sh.a-Dega Kosovë**

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a - Kosovo Branch

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a - Kosovo Branch (më poshtë "Dega"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës se parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Degës më 31 dhjetor 2016, dhe të rezultatit të saj financiar dhe rrjedhës se parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Degës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka lëshuar një opinion të pa modifikuar më 6 prill 2016.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Dega në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Degës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likuidojë Degën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Menaxhmenti është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Degës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Degës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Degës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Dega të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group Sh.a - Kosovo Branch përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti tjetër mbi kërkesat rregullatore të autoritetit mbikëqyrës, Bankës Qendrore të Kosovës, për Investime në Rezervat Teknike.

Në bazë të kërkesave të Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), ne kemi lexuar Shënime Plotësuese për Investimet në Rezervat Teknike ("Shënime Plotësuese"). Këto Shënime Plotësuese të përgatitura nga menaxhmenti nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në Shënime Plotësuese të përgatitura nga menaxhmenti, është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin financiar vjetor të shpalosur në pasqyrat financiare të Degës më 31 dhjetor 2016, të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të aplikueshme për kompanitë e sigurimeve në Kosovë. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e Shënimeve Plotësuese, në përputhje me Rregulloren e BQK-së "Rregullore për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve" të datës 29 dhjetor 2016.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
Prishtinë, Kosovë
31 mars 2017

(Të gjitha shumat janë në EUR, përvec nëse theksohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	10	428,741	935,632
Depozita me afat	11	10,286,432	8,435,868
Investimet e letrave me vlerë	12	2,909,482	3,242,788
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	13	362,499	467,179
Kostot e marrjes në sigurim	14	661,674	607,699
Pasuritë e risigurimit	15	3,633,812	3,084,667
Prona dhe pajisjet	16	235,202	281,898
Pasuritë e paprekshme	17	60,160	64,735
Pasuritë tjera	18	385,303	252,660
Gjithsej pasuritë		18,963,305	17,373,126
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	19	3,200,000	3,000,000
Fitime të mbajtura	19	2,090,852	1,989,227
Gjithsej ekuiteti		5,290,852	4,989,227
Detyrimet			
Rezerva teknike për dëmet	20	7,411,585	6,724,359
Rezerva për primet e pafituara	21	3,575,604	3,369,769
Depozita për risigurimet	22	1,983,699	1,679,886
Të pagueshme për sigurime dhe të tjera	23	701,565	609,885
Gjithsej detyrimet		13,672,453	12,383,899
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		18,963,305	17,373,126

Shënimet shoqeruese në faqet 5 deri në 37 janë një pjesë përberëse e pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për lëshim me datë 17 mars 2017 nga:

Roland Kacani

Drejtor i Përgjithshëm



Gylsa Reka Spahija

Drejtoreshë Financiare




Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë në EUR, përvec nëse theksohet ndryshe)

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

	Shënime	2016	2015
Prime të shkruara bruto	24	9,679,959	10,874,428
Prime të ceduara ndaj risiguruesve	21	(4,445,708)	(4,408,310)
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	25	(205,835)	86,126
Ndryshimi në rezervën për prime të pafituara të risigurimit	15	274,590	(68,992)
Portofoli i rezervës së primeve		(90,668)	(20,485)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		5,212,338	6,462,767
Të ardhura (shpenzime) të tjera		9,826	(2,358)
Të ardhura neto		5,222,164	6,460,409
Dëme të paguara	20	(3,268,275)	(4,443,725)
Humbje nga risigurimet e ceduara	20	779,082	1,018,009
Ndryshime në rezervën e dëmeve, neto nga pjesa e risigurimit	20	(412,671)	(923,145)
Totali i humbjeve dhe shpenzimeve për rregullimin e humbjeve		(2,901,864)	(4,348,861)
Shpenzime për komisione	26	(916,977)	(888,094)
Ndryshimi në kostot e shtyra	27	53,975	68,556
Shpenzime administrative dhe marketingu	28	(2,018,228)	(2,105,652)
Komisione të risigurimit	29	1,167,641	1,344,706
Totali i shpenzimeve		(1,713,589)	(1,580,484)
Të ardhura nga interesi	30	261,470	216,357
Shpenzime nga interesi	30	(62,821)	(71,821)
Te ardhura nga kurset e këmbimit		(104)	1,500
Të ardhura financiare neto		198,545	146,036
Fitimi para tatimit		805,256	677,100
Shpenzimi i tatimit për të ardhurat nga interesi		(19,633)	(17,136)
Shpenzimi i tatimit për primet		(483,998)	(543,721)
Fitimi i vitit		301,625	116,243
Të ardhura gjithpërfshirëse të tjera për vitin, neto nga taksat		-	-
Të ardhura gjithpërfshirëse të tjera		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse të vitit		301,625	116,243

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 37 janë një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016

	Detyrime ndaj aksionarëve	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2015	3,000,000	2,425,234	5,425,234
Fitimi i vitit	-	116,243	116,243
Të ardhura gjithpërfshirëse të tjera	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	-	116,243	116,243
Kontribute të dhe shpërndarë te pronarët e kompanisë			
Transferi tek kompania mëmë	-	(552,250)	(552,250)
Totali i kontributeve të shpërndara te pronarët e kompanisë	-	(552,250)	(552,250)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	3,000,000	1,989,227	4,989,227
Fitimi i vitit	-	301,625	301,625
Transferim tek kapitali aksionar	200,000	(200,000)	-
Të ardhura gjithpërfshirëse të tjera	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	3,200,000	2,090,852	5,290,852
Kontributet nga dhe distribuimet tek pronarët e kompanisë			
Transferi tek kompania mëmë	-	-	-
Totali i kontributeve të dhe shpërndarë te pronarët e kompanisë	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,200,000	2,090,852	5,290,852

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 37 janë një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.